



## KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT NGA ZJARRI

### PËRCAKTIME TË PËRGJITHSHME

1. Kushtet e përgjithshme të kontratës për Sigurimin nga Zjarri, këtu e në vazhdim do të quhen shkurtimisht "Kushtet e Sigurimit".

ALBSIG, këtu e në vazhdim do të quhet shkurtimisht "Siguruesi".

Personi fizik ose juridik, interesi pasuror i të cilit është siguruar në kontratën e sigurimit dhe mbulimeve të zgjedhura dhe pranuar prej Tij, ku për efekt dëmshpërblimi, dëmet do të mbulohen sipas këtyre Kushteve të Sigurimit, referuar rubrikave që i korespondojnë rreziqeve të siguruar në kontratën e sigurimit këtu e në vazhdim do të quhet shkurtimisht "i Siguruari".

Personi fizik ose juridik, që ka interes pasuror mbi objektin e siguruar dhe në dobi të cilit lidhet kontrata, këtu e në vazhdim do të quhet "Përfituesi".

### OBJEKTI I SIGURIMIT

2. I Siguruari mund të sigurojë pranë Siguruesit, pasuri që ka në pronësi të tij ose gëzon të drejta përdorimi dhe shfrytëzimi në atë pasuri, sipas një kontrate që përmbush kërkesat ligjore, të lidhur me pronarin e pasurisë apo sendit. Përfundimisht i Siguruari duhet të ketë interes pasuror në objektin e siguruar.

3. Siguruesi ofron Sigurimin nga Zjarri për objektet e mëposhtme:

- pasurinë e patundshme, ndërtesat dhe pjesë të tjera të njësisë,
- pasurinë e tundshme.

Njësi e siguruar do të konsiderohet të jenë ndërtesat ose dhomat e ndërtesave ose vendet e përcaktuara si të tilla në kontratën e sigurimit.

Nuk do të mbulohen në sigurim sendet vetiake që u përkasin dhe përdoren nga punonjësit, përveç rasteve kur janë përcaktuar shprehimisht në Policën e Sigurimit.

4. Pasuria e luajtshme, do të mbulohet vetëm në njësinë e siguruar.

5. Sigurimi i pajisjeve nuk do të përfshijë:

- Specimenet, modelet ose kampionet, ose stampat për prodhimin e një lloji të veçantë produkti, që nuk nevojiten më, për prodhimin vijues;
- mjetet motorrike, rimorkiot ose traktorët, që kërkojnë regjistrim, targe.

6. Makinat e fatit, makinat automatike për thyerjen e tërheqjen e parave, përfshirë përmbajtjet e tyre do të mbulohen në sigurim vetëm në se për to është rënë dakord shprehimisht në kontratën e sigurimit.

7. Objektet e mëposhtme do të sigurohen vetëm në kasaforta sipas llojit të përshkruar në kontratë:

- kartmonedha;
- dokumenta, si libreza kursimesh, libra llogarie, letra me vlerë, etj;
- pulla poste;
- monedha e medalje;

e. metale të çmuar të papërpunuar dhe objekte të prodhuara nga metale të çmuar, përveç objekteve që shërbejnë si zbukurime dhome;

f. bizhuteri, perla e gurë të çmuar;

g. objekte për të cilat është rënë dakord në mënyrë të veçantë mes palëve.

8. Kartmonedhat do të mbulohen gjatë orëve të punës deri në një shumë të përcaktuar shprehimisht në policën e sigurimit, pavarësisht se ato nuk janë vendosur në kasafortë, sipas llojit të parashikuar në kontratë.

### RREZIQET E SIGURIMIT

9. Siguruesi dëmshpërblen të Siguararin për humbjen, dëmtimin ose shkatërrimin e pasurisë së siguruar në mënyrë të papritur, të paparashikuar dhe aksidentale si pasojë e:

- zjarrit;
- rrufesë;
- d. përplasjes ose rënies së një avioni, pjesëve ose ngarkesës së tij;
- përpjekjeve për shuarjen e zjarrit, prishjeve ose lëvizjeve në lidhje me çdo njërin prej ngjarjeve të mësipërme, në kufirin deri 3 % të shumës së siguruar.

10. Rreziqet e mbuluara përcaktohen si më poshtë:

- Zjarr do të konsiderohet të jetë një formë e djegies me flakë e të mirave materiale jashtë vatrës që ekziston qëllimisht për të, e aftë të vetëpërhapet dhe të vetëzgjerohet.
- Rrufe do të konsiderohet të jetë një shkrepje e rrufesë, e cila godet një objekt drejtpërdrejt.

### PËRJASHTIME

11. Nuk do të mbulohen dëmet e shkaktuara nga implozioni.

12. Nuk do të mbulohet fitimi i munguar dhe dëmet vijuese të çdo lloji dhe natyre të tillë si, dëmet për shkak të vonesave, moskryerjes, humbjes së kontratës, gjobat etj.

13. Nuk do të mbulohen dëmet e mëposhtme:

- dëmtimi nga zjarri i objekteve të siguruar shkaktuar nga vënia e tyre në zjarre utilitare (zjarre përdorimi ose shërbimi) ose nga trajtimi i tyre me nxehje, sa më sipër do të zbatohet gjithashtu për objektet në të cilat ose nëpërmjet të cilave prodhohet ose përçohet zjarri ose nxehtësia utilitare;
- djegiet sipërfaqësore, përveç se kur shkaktohen nga njëri prej rreziqeve të mbuluara në nenin 9;
- dëmi në motorët me djegie të brëndshme shkaktuar nga shpërthimet e ndodhura brenda dhomës së djegies;
- dëmi i shkaktuar në kontaktet e çelësve elektrike si rrjedhojë e presioneve të gazrave që lindin brenda tyre;
- dëme në makineri, pajisje, aparaturë (elektrike dhe/ose elektronike), si edhe në çdo pjesë të vetë instalimit të rrjetit të energjisë elektrike, që



shkaktohet nga defekte të vetë rrjetit elektrik, dhe/ose defekte të brendshme të makinerive, pajisjeve dhe aparaturave.

**Defekt**, sipas termit të sipërpermendur do të konsiderohet, mbirryma, tejkalimi i kufinjve normale të tensionit, mbitensioni ose nëntensioni, defekteve të izolimit si qarqe të shkurtër, kontakte trupore ose defekte tokëzimi; kontaktit të pamjaftueshëm, mosfunksionimit të instalimeve të matjes, kontrollit ose sigurisë, etj, të kësaj natyre, **por janë të mbuluara të gjitha dëmet e pasojat e shkaktuara në pasurinë tjetër, të tundshme apo të patundshme, nga zjarri i filluar nga këto defekte.**

- f. dëmi në çdo makineri dhe aparature elektrike, ose në çdo pjesë të instalimit elektrik si pasojë e rrufesë, nëse ky dëm nuk është shkaktuar nga goditja direkte e rrufesë;
- g. dëmi nga zjarri, i cili shkaktohet nga tërmeti;
- gj. dëmi shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rëndë e të Siguarit, punonjësve të tij dhe/ose anëtarëve madhore të familjes së tij.
- h. dëmi shkaktuar direkt ose indirekt nga veprimet (aktet) keqdashëse.  
Me veprime (akte) keqdashëse do të kuptohet humbja, shkatërrimi ose dëmtimi (shkaktuar nga zjarri, ose të tjera) e Pasurisë së Siguarit shkaktuar direkt ose indirekt nga dëmtimet keqdashëse të çdo personi ose grup personash, pavarësisht nëse një akt i tillë është bërë ose jo si pasojë e prishjes së qetësisë publike.

**14.** Ky sigurim nuk do të mbulojë dëmtimin e objekteve të siguruara ose shpenzimet e siguruara të lindura ose të shkaktuara drejtpërdrejt ose indirekt si pasojë e :

- a. shpërthimit bërthamor, rrezatimit bërthamor dhe ndotjes radioaktive;
- b. luftës së çdo lloji, invazionin, luftime të tjera të armatosura pavarësisht nëse është deklaruar lufta ose jo, luftën civile;
- c. revolucione, lëvizje separatiste, kryengritje popullore, rebelime, revolta, puçe, demonstrata, tubime, grushte shteti, eksode;
- d. konfiskime, rekuizime, shtetëzime ose shkatërrime të pronës së siguruar të detyruara të kryera me urdhër të çfarëdolloj qeverie apo autoriteti shtetëror;
- e. greva, trazira, turbullira civile, lokauti, sabotimi, terrorizmi.  
Terrorizëm do të konsiderohet kryerja e veprimeve të dhunshme, nga anëtarët e një organizate të shpallur të jashtëligjshme, nëpërmjet dëmtimeve e shkatërrimeve masive ndaj pasurisë, që kanë si qëllim turbullimin e rendit publik dhe ngjalljen e frikës e të pasigurisë së publikut;
- f. shpalljen e ligjit të luftës, deklarimit dhe vendosjes së gjëndjes së jashtëzakonshme, anarkia ose mosfunksionimi i shtetit, qoftë edhe në pjesë të caktuara të vendit.

**15.** Nëse në rastin e një dëmi Siguruesi përdor të drejtën e tij për të mos dëmshpërbleyer në bazë të përjashtimeve në kushtet e përgjithshme, i Siguruari do të jetë përgjegjës për të provuar se dëmi që ka ndodhur nuk ishte shkaktuar direkt ose indirekt në lidhje me keto përjashtime.

#### **SHPENZIME TË MBULUARA**

**16.** Siguruesi do të dëmshpërblejë shpenzimet, përfshirë edhe ato pa efekt, që i Siguruari i ka quajtur të nevojshme të kryej për të mënjanuar ose minimizuar dëmin (neni 48/C i Kushteve të Përgjithshme). Kompensimi i këtyre shpenzimeve së bashku me dëmshpërblimin për njësitë e siguruara nuk do të kalojë shumën e siguruar për njësi. Në rastin e nënsigurimit, shpenzimet do të rimbursohen në të njëjtin përpjestim si dëmtimi, pavarësisht nga udhëzimet e dhëna nga Siguruesi.

Nuk do të dëmshpërblehen shpenzimet për shërbimet e kryera nga njësitë zjarrfikëse ose persona të tjerë të detyruar për të dhënë ndihmë në interes të popullatës si dhe kur Siguruesi provon se mjetet e përdorura dhe shpenzimet e bëra nga i Siguruari janë përdorur ose janë bërë pa kujdes.

**17.** Siguruesi do të rimbursojë shpenzimet që kryhen në vijim të dëmit, si shpenzimet e pastrimit në vendndodhjen e dëmit, përfshi prishjen e pjesëve të pavlefshme, heqjen e mbeturinave dhe mbetjeve të tjera në vendim më të afërt të hedhurinave dhe shpenzimet e depozitimit ose shkatërrimit të tyre (shpenzimet e prishjes dhe heqjes së mbeturinave), të vlerësuar sipas një preventivi, por jo më shumë se **3 %** e shumës së siguruar, sidoqoftë, nuk do të mbulohen shpenzimet e pastrimit nga ndotja e tokës ose e ujit.

#### **VLERA DHE SHUMA E SIGURUAR**

**18.** Vlera e siguruar e ndërtesave do të jetë:

- a. vlera e zëvendësimit;  
Vlera e zëvendësimit do të jetë vlera lokale e ndërtimeve duke përfshirë shpenzimet e arkitektit dhe shpenzime të tjera të projektimit;
- b. vlera aktuale;  
Vlera aktuale do të jetë e barabartë me vlerën e zëvendësimit të ndërtesës minus një zbritje në përputhje me gjendjen aktuale të saj, sipas normave të amortizimit referuar ligjit ;
- c. vlera e tregut;  
Vlera e tregut do të jetë e barabartë me çmimin e mundshëm të shitjes së ndërtesës ose vlerën e materialit që mund të përfitojë i Siguruari nga prishja e saj.

Në rast dëmi do të operohet sipas parashikimeve të neneve 18, 21 dhe 52 të kushteve të përgjithshme.

**19.** Vlera e siguruar e makinerive dhe pajisjeve do të jetë:

- a. vlera e zëvendësimit;  
Vlera e zëvendësimit do të jetë vlera për t'u paguar për blerjen ose prodhimin e objekteve të njëjtit tip dhe cilësi në një gjendje si të reja, cilado qoftë shumta më e ulët.

**b. vlera e tregut,**

Në të gjitha rastet kur makineritë dhe pajisjet kanë më shumë se 7 vjet nga vënia e tyre në punë, si të reja, dhe ekziston tregu për shitjen e të njëjtave, në tip dhe karakteristika të tjera, vlera e siguruar e tyre do të orientohet nga çmimi i atij tregu.

Në çdo rast ndryshe, vlera e siguruar e makinerive dhe pajisjeve nuk do të kalojë 20%, të vlerës së tyre të zëvendësimit, ose çmimit të tyre në kohën e blerjes, si të reja.

**20. Vlera e siguruar e:**

- a.** mallrave të prodhuara nga i Siguruari, edhe në se nuk janë përfunduar;
- b.** mallrave që tregtohen nga i Siguruari;
- c.** lëndëve të para;
- d.** produkteve natyrore;  
do të jetë shuma që duhet paguar për blerjen ose prodhimin e objekteve të njëjtit lloj dhe cilësi, cilado qoftë shuma më e ulët.
- e.** sendeve dhe pajisjeve shtëpiake do të jetë vlera e tyre e zëvendësimit .

**21. Shuma e siguruar, do të jetë e barabartë me vlerën e sigurimit.**

Baza mbi të cilën do të përcaktohet shuma e siguruar do të vendoset në Policën e Sigurimit.

**a. Për ndërtesat;**

- Shuma e siguruar, do të jetë e barabartë me vlerën e zëvendësimit të saj.
- Në qoftë se vlera aktuale është më e vogël se 80% e vlerës së zëvendësimit, shuma e siguruar do të jetë e barabartë me vlerën aktuale.
- Në qoftë se vlera e tregut është më e vogël se vlera aktuale, shuma e siguruar do të jetë e barabartë me vlerën e tregut.

**b. Për makineri dhe pajisje;**

- Shuma e siguruar, do të jetë e barabartë me vlerën e zëvendësimit të tyre.
- Në të gjitha rastet kur një makineri ose grup makinerish (linja prodhimi), konsiderohen të amortizuara, fizikisht dhe/ose moralisht (kanë kaluar 7 vjet nga vënia në punë, si të reja), dhe ekziston një treg për shitjen e të njëjtave në tip dhe cilësi, shuma e siguruar e tyre, do të jetë e barabartë me çmimin e atij tregu.  
Në çdo rast tjetër shuma e siguruar nuk mund të kalojë 20% të çmimit të tyre të blerjes si të reja.

**c. Për mallra, lëndë të para etj.;**

- Shuma e siguruar do të jetë e barabartë me vlerën maksimale të tyre, e cila përfaqëson vlerën maksimale të mundshme të mallrave të depozituara, deklaruar me shkrim nga i Siguruari.
- Në raste të veçanta, shuma e siguruar do të jetë e barabartë me vlerën mesatare të tyre, e cila përfaqëson vlerën mesatare që i Siguruari parashikon të ketë gjatë vitit, deklaruar me shkrim nga i Siguruari.

**22. Në rast të sigurimit në “ bazë të rrezikut të parë”, i cili do të deklarohet shprehimisht në Policën e Sigurimit, shuma e siguruar do të përfaqësojë një pjesë të vlerës së**

plotë dhe Siguruesi do të paguajë në rast dëmi duke zbatuar kushtin e nënsigurimit.

Primi i sigurimit do të jetë më i lartë nga ai i llogaritur për sigurimin në bazë të vlerës së plotë.

**POLICA E SIGURIMIT**

**23.** Polica e sigurimit (dëshmia e sigurimit) që Siguruesi i lëshon të Siguarit, vërteton lidhjen e kontratës së sigurimit.

Nëse Polica e Sigurimit humbet ose dëmtohet në masën që bëhet e pavlefshme, me kërkesën dhe shpenzimet e të Siguarit, Siguruesi duhet të lëshojë një dublikatë të saj.

**24.** Kontrata e Sigurimit lidhet në bazë të kërkesës me shkrim të Siguarit.

Siguruesi lëshon Policën e Sigurimit dhe përcakton primin e sigurimit në bazë të Pyetësorit dhe Kërkesës për Sigurim dhe deklarimeve të bëra nga i Siguruari.

Kërkesa, njoftimet e deklarimet e tjera të Siguarit i bashkëngjiten Policës së Sigurimit dhe janë pjesë përbërëse e saj.

I Siguruari është përgjegjës lidhur me saktësinë dhe vërtetësinë e njoftimeve dhe deklarimeve të bëra prej tij.

**25.** Siguruesi ka të drejtë të verifikojë vërtetësinë e njoftimeve dhe deklarimeve të Siguarit dhe të kryejë inspektime me ekspertë të fushës për saktësime të dhënash.

**PERIUDHA E SIGURIMIT**

**26.** Periudha e sigurimit si rregull është jo më pak se një vit, përveç rasteve kur në Policën e Sigurimit përcaktohet ndryshe, por jo më pak se tre muaj, përjashtuar raste të tilla si ekspozita, panaire etj.

**27.** Mbulimi në sigurim fillon në orën 24.00 të ditës së përcaktuar si ditë e fillimit në Policën e Sigurimit, me kusht që të jetë paguar më parë primi i sigurimit ose nëse raste të veçanta kësti përkatës sipas dakortësisë mes palëve.

Mbulimi në sigurim përfundon në orën 24.00 të ditës së përcaktuar si ditë mbarimi në Policën e Sigurimit.

Përgjegjësia e Siguruesit do të fillojë në momentin kohor të përcaktuar në policë, edhe nëse pagesa e primit të sigurimit kryhet më parë.

**PRIMI I SIGURIMIT**

**28.** Pagesa e primit të sigurimit bëhet në një nga llogaritë bankare të Albsig, ose pranë Degës dhe agjencisë së Siguruesit ku lëshohet Polica e Sigurimit.

Pagesa do të quhet e kryer në momentin e kalimit të shumës së caktuar në llogarinë bankare të Siguruesit.

Primi i sigurimit paguhet në monedhën e përcaktuar në Policën e Sigurimit.

**29.** I Siguruari detyrohet t'i paguajë Siguruesit primin e sigurimit sipas shumave dhe afateve të përcaktuara në kontratë.

Primi i sigurimit mund të paguhet tërësisht ose me këste, sipas këtyre rregullave:

- a.** kur periudha e sigurimit është një vit primi i sigurimit do të paguhet njëherësh;

b. kur periodha e sigurimit është mbi një vit, primi i sigurimit mund të paguhet me këste (sipas dakortësisë mes palëve), numri, vlera nominale e secilit këst dhe datat e maturimit të tyre, përcaktohen nga palët (i Siguruari dhe Siguruesi), dhe shënohen në Policën e Sigurimit, por kësti i fundit duhet të paguhet jo më vonë se 3 muaj nga data e mbarimit të afatit të policës së sigurimit.

**30.** Kur polica lidhet për një periudhë siguri shumë vjeçare dhe klienti është i gatshëm që të paguajë primin njëherësh, mbi primin për t'u paguar, do të zbatohet ulje në këto nivele:

Në rastet kur periodha e sigurimit është, më shumë se 2 deri në 5 vite do të aplikohet ulje deri në 10% të primit total, kur periodha e sigurimit është më shumë se 5 vite do të aplikohet ulje deri 20%, të primit total.

**31.** I Siguruari detyrohet t'i paguajë Siguruesit primin e sigurimit në afatet e caktuara në Policën e Sigurimit. Nëse primi ose kësti i parë i tij nuk paguhet në afat, mbulimi në siguri pezullohet deri në orën 24.00 të ditës, që i Siguruari paguan shumën që detyrohet.

Kur i Siguruari nuk paguan primet (këstet) në vazhdim sipas afateve të caktuara, siguri pezullohet në ora 24.00, të ditës së pesëmbëdhjetë duke filluar nga data e maturimit të këstit të rradhës të papaguar, dhe Siguruesi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e Kontratës së Sigurimit.

Humbjet dhe dëmtimet e vërtetuara brenda afatit të mësipërm dëmshpërblehen vetëm pasi të jetë zbritur shuma e kësteve vijuese të primit të sigurimit.

**32.** Mospagimi në kohë i këstit të dytë dhe/ose vijues të primit të sigurimit, sipas përcaktimeve në policë, të bëra nga palët në momentin e lidhjes së kësaj police, sjell si pasojë zgjidhjen e kontratës së sigurimit, pa detyruar Siguruesin të bëjë njoftim të veçantë, të Siguararit, përveç njoftimit të bërë atij, për t'i kujtuar detyrimin për të paguar në kohën e përcaktuar në policë dhe parashikimeve të këtyre Kushteve të Përgjithshme.

**33.** Kur pasuria e siguruar kalon në pronësinë e një të treti (personi tjetër), kontrata e sigurimit quhet e zgjidhur. Në këtë rast primi i paguar i kthehet të Siguararit në përpjestim me kohën që mbetet deri në mbarim të afatit të kontratës duke i zbritur shpenzimet e marrjes në siguri dhe detyrimet tatimore ta paguara nga Siguruesi, me kusht që i siguruari mos të ketë marrë dëmshpërblim nga kjo policë siguri, në rast se i siguruari ka përfituar dëmshpërblim gjatë afatit të shkruar në policën e sigurimit, Siguruesi çlirohet nga detyrimi për ti kthyer pjesën e mbetur të primit të sigurimit.

#### **INTERESI I SIGURUAR**

**34.** Nëse interesi i siguruar (objekti i sigurimit) pushon së ekzistuari pas fillimit të sigurimit si rrjedhojë e një akti lufte ose një veprimi administrativ në rast lufte ose nëse pushimi i interesit është pasojë e paevitueshme e luftës, Siguruesi ka të drejtë të mbajë pjesën e primit që i përket periudhës së mbulimit të rrezikut.

**35.** Nëse interesi i siguruar pushon së ekzistuari për shkak të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, Siguruesi ka të drejtën e primit për të gjithë periudhën e sigurimit.

#### **PJESA E ZBRITSHME**

**36.** Në policat e sigurimit të pasurisë nga zjarri dhe rreziqet shtesë, do të aplikohet pjesë e zbritshme dhe franshizë.

Siguruesi nuk do të trajtojë dëme të veçanta, që janë nën shumën e përcaktuar si franshizë, në Policën e Sigurimit.

Për çdo rast dëmi të trajtueshëm, Siguruesi do të zbrësë nga dëmshpërblimi i llogaritur pjesën e zbritshme të përcaktuar, në policën e Sigurimit, si përqindje mbi çdo një dëm ose seri dëmsh, të shkaktuara nga një ngjarje e vetme siguri.

Masat e pjesës së zbritshme dhe franshizës do të përcaktohen në Policën e Sigurimit.

#### **DETYRIME**

**37.** I Siguruari, në kohën e lidhjes së kontratës së sigurimit, duhet të informojë me shkrim Siguruesin për të gjitha rrethanat e njohura prej tij dhe që janë thelbësore për vlerësimin e rrezikut. Rrethanat janë thelbësore, nëse ato janë të një natyre të tillë që mund të influencojnë vendimin e Siguruesit për të përfunduar ose jo kontratën, apo për kushtet që duhet të vendosë, në atë kontratë.

Nëse i Siguruari me qëllim nuk e përmbush këtë detyrim, Siguruesi ka të drejtë të ndryshojë masën e primit të sigurimit, të shumës së sigurimit ose afatin e sigurimit si dhe zgjidhjen e kontratës së sigurimit.

Siguruesi mund gjithashtu të zgjidhë kontratën e sigurimit nëse i është dhënë informacion i gabuar, në këtë rast primi i sigurimit nuk i kthehet të Siguararit.

Në rast dëmi, Siguruesi lirohet nga detyrimi për dhënie dëmshpërblimi kur shkak i dëmit është një rrethanë që nuk i ishte bërë e njohur atij nga i Siguruari.

Këto dispozita janë të vlefshme edhe për Përfituesin, nëse vërtetohet nga Siguruesi se ai kishte dijeni për pasaktësinë e deklarimeve ose harresave në lidhje me rrezikun.

Gjithashtu nëse i Siguruari nuk plotëson detyrat e lëna nga ana e Siguruesit ose të ekspertëve të kontraktuar prej Siguruesit gjatë procesit të marrjes në siguri, që kanë të bëjnë me sigurinë e objektit dhe shmangjen e ngjarjeve aksidentale, në rast dëmi Siguruesi çlirohet nga detyrimi nëse shkak për dëmin janë bërë rekomandimet që atij i janë lënë dhe nuk i ka plotësuar.

**38.** Pas plotësimit të kërkesës për siguri, i Siguruari nuk mund të kryejë ose lejojë ndryshime që sjellin shtimin e rrezikut, pa miratimin me shkrim të Siguruesit.

I Siguruari duhet të informojë menjëherë me shkrim Siguruesin për çdo shtim të rrezikut për të cilin vihet në dijeni, edhe nëse një shtim i tillë ndodh pa pëlqimin e tij.

Me shtim të rrezikut, kuptohen rrethanat që janë thelbësore dhe të një natyre të tillë, që mund të influencojnë vendimin e Siguruesit për të përfunduar ose jo kontratën, apo për kushtet që duhet të vendosë.

Në rast të mosnjoftimit të Siguruesit, ky i fundit ka të drejtë të çlirohet nga detyrimi për dhënien e dëmshpërblimit.

**39.** Nëse ndryshimi i veprimtarisë së njoftuar, përfshin shtim të rrezikut, Siguruesi do të ketë të drejtë që nga dita që është ndërmarrë ose ndryshuar veprimtaria, për një prim më të lartë.

Sa më sipër, nuk do të zbatohet nëse Siguruesi është çliruar nga plotësimi i detyrimit të tij në rast dëmi, për shkak të shtimit të rrezikut sipas parashikimit të nenit 37, më sipër.

**40.** I Siguruari duhet:

- a. të plotësojë të gjitha kërkesat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes nga zjarri, përshkruar në rregulloren për mbrojtjen nga zjarri të biznesit përkatës, akte të ndryshme ligjore dhe nënligjore në fuqi, dhe/ose ato përcaktime të bëra në kontratën e zjarrit; të rregulluar nga këto Kushte të Përgjithshme;
- b. të ketë të regjistruara letrat me vlerë dhe dokumenta të tjerë, koleksione dhe objekte të tjera për të cilat janë parashikuar që të kryhen regjistrime, dhe t'i ruajë ato në mënyrë të tillë që të mos ketë mundësi të dëmtohen ose humbasin së bashku me objektet e siguruar.

**41.** Nëse i Siguruari nuk arrin të plotësojë kushtet e përcaktuara më sipër, Siguruesi, brenda një muaji nga dita që ka marrë dijeni, mund të zgjidhë kontratën e sigurimit duke e njoftuar të Siguarin me shkrim. Siguruesi do të lirohet nga detyrimi për dhënien e dëmshpërblimit nëse shkaku i dëmit ose humbjes është mosplotësimi i detyrimeve, me qëllim ose nga neglizhenca e rëndë e të Siguarit.

#### **SIGURIME TË TJERA**

**42.** Nëse i Siguruari kryen sigurime të tjera, kundrejt të njejtëve rreziqeve të siguruar për mbulimin e objekteve pasurore si në këtë kontratë, duhet të njoftojë menjëherë me shkrim Siguruesin, për emrin/at e Siguruesit/ve të tjerë dhe shumën/at e siguruar.

Kur i Siguruari me qëllim nuk jep njoftimin e sipërm, Siguruesi nuk është i detyruar të paguajë shpërblimin e dëmit.

**43.** Masa e dëmshpërblimit që përfiton i Siguruari nga të gjitha policat, nuk mund të jetë më e lartë se masa e dëmit, minus pjesën e zbritshme më të lartë të vërtetuar ndër policat në fuqi, në momentin e ndodhjes së dëmit.

**44.** Nëse i Siguruari kryen sigurime të tjera me qëllim që të arrijë përfitime të paligjshme, kontrata e sigurimit quhet e pavlefshme dhe Siguruesi mban primin e sigurimit.

#### **MBISIGURIMI**

**45.** Nëse shuma e siguruar e tejkalon ndjeshëm vlerën e sigurimit, atëherë si Siguruesi ashtu edhe i Siguruari mund të kërkojnë zvogelimin e shumës së siguruar, dhe primi i sigurimit do të pakësohet përkatësisht.

Në çdo rast i Siguruari nuk mund të përfitojë dëmshpërblim në vlerë më të madhe se humbja e pësuar nga ngjarja e sigurimit, cilado qoftë shuma e siguruar e shënuar në policen e sigurimit.

**46.** Nëse i Siguruari lidh kontratën e sigurimit me qëllim që të arrijë përfitime të paligjshme nga mbisigurimi, kontrata

quhet e pavlefshme. Siguruesi ka të drejtën e mbajtjes së primit të sigurimit.

#### **NËNSIGURIMI**

**47.** Nëse në momentin menjëherë para ndodhjes së ngjarjes së sigurimit shuma e siguruar e shënuar në policë është më e ulët se vlera e sigurimit, dëmshpërblimi i llogaritur sipas nenit **53** do të shumëzohet me koeficientin e nënsigurimit, i cili përcaktohet si raport i shumës së siguruar ndaj vlerës së sigurimit.

#### **NGJARJA E SIGURIMIT**

**48.** Në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, i Siguruari duhet:

- a. të njoftojë me shkrim menjëherë Siguruesin duke specifikuar rrethanat e ngjarjes, gjithashtu të njoftojë organet e Rendit dhe ato të mbrojtjes nga zjarri (PMNZSH).  
Një njoftim i tillë do të quhet i dhënë Siguruesit menjëherë, nëse i është dërguar atij, brenda 24 orëve nga ndodhja e ngjarjes, ose marrja dijeni për të;  
Kostot e marrjes së vërtetimeve të ndryshme prej organeve përkatëse lidhur me ngjarjen, shkaqet etj, paguhen nga Porositësi.
- b. t'i japë menjëherë rajonit përkatës të policisë një listë të objekteve të dëmtuara;
- c. të shmangë ose minimizojë humbjet ose dëmtimet me sa është e mundur dhe gjatë këtyre veprimeve të ndjekë udhëzimet e Siguruesit; i Siguruari është i detyruar të kërkojë dhënien e këtyre udhëzimeve nëse e lejojnë kushtet;
- d. të bllokojë librat e llogarisë dhe dëshmi të tjera të pasurisë së tij;
- e. të lejojë Siguruesin, me kërkesën e tij dhe për sa është e arsyeshme, të hetojë lidhur me shkakun dhe shumën e humbjes si dhe masën e dëmshpërblimit, duke i dhënë çdo informacion që ndihmon hetimin;
- f. të mos ndryshojë asgjë në vendngjarje pa miratimin e Siguruesit, përveç rasteve kur ndryshimet janë të detyruara të bëhen nga oragnet e hetimit.
- g. t'i dorëzojë Siguruesit brenda 10 ditëve nga ndodhja e ngjarjes një listë të firmosur të gjitha objekteve të humbura, dëmtuara apo shkatërruara, si dhe vlerën për të cilën kërkon të dëmshpërblehet.

**49.** Nëse i Siguruari, me qëllim apo për neglizhencë, nuk zbaton tërësisht apo pjesërisht detyrimet e mesipërme, Siguruesi çlirohet nga përbushja e detyrimeve të tij.

Nëse organi i rendit nuk është njoftuar për objektet e humbura apo dëmtuara në kohë, Siguruesi ka të drejtë të çlirohet nga detyrimi i tij vetëm për këto objekte.

#### **DËMSPËRBLIMI**

**50.** Nëse i Siguruari përpiket të paraqesë në mënyrë të shtrembër ose mashtruese faktet para Siguruesit, fakte të cilat kanë rëndësi për mundësinë ose masën e

dëmshpërblimit, Siguruesi ka të drejtë të çlirohet nga detyrimet e tij.

**51.** Nëse padia për dëmshpërblim nuk është paraqitur në Gjykatë brenda dy vjetësh nga data e ngjarjes, Siguruesi çlirohet nga detyrimet e tij.

**52.** Siguruesi do të dëmshpërblejë të Siguruarin për dëmin, duke paguar me para, riparuar ose zevëndësuar, sipas zgjedhjes së Siguruesit.

Detyrimi i Siguruesit për dëmshpërblim kufizohet deri në masën e shumës së siguruar.

Dëmshpërblimi nuk mund të jetë më i madh se masa e humbjes, edhe nëse në momentin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, shuma e siguruar e shënuar në policë është më e lartë, se vlera e sigurimit.

**53.** Do të dëmshpërblehet, mbi bazën e përllogaritjeve, si më poshtë:

**a. Ndërtesat ;**

- në rastin e objekteve të shkatërruara ose të humbura plotësisht, si pasojë e një ngjarje sigurimi, Siguruesi do të dëmshpërblejë deri në shumën e siguruar, përcaktuar sipas parashikimeve të neneve 18 dhe 21/a,
- në rastin e objekteve të dëmtuara pjesërisht, si pasojë e një ngjarje sigurimi, Siguruesi do të dëmshpërblejë shpenzimet e riparimit që bëhen të nevojshme nga dëmtimi, deri në shumën e siguruar të çdo pjese të objektit të siguruar, sipas parashikimeve të neneve 18 dhe 21/a.

Kur sigurimi është bërë në bazë të vlerës aktuale do të bëhet një zbritje në përputhje me shkallën e amortizimit sipas ligjit.

**b. Makineri dhe pajisje;**

- në rastin e objekteve të shkatërruara plotësisht ose të humbura, Siguruesi do të dëmshpërblejë vlerën e objektit menjëherë para ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, deri në shumën e sigurimit, sipas parashikimeve të neneve 19 dhe 21/b, të përcaktuar në Policën e Sigurimit. Shpenzimet për transportin, koston e montimit, taksat doganore, do të dëmshpërblehen në qoftë se në momentin e marrjes në sigurim, këto shpenzime janë përfshirë veçanërisht në shumën e siguruar;
- në rastin e objekteve të dëmtuar pjesërisht, Siguruesi do të dëmshpërblejë shpenzimet e nevojshme që duhet të bëhen për restaurimin e makinës së dëmtuar e kthimin e saj në gjendjen e mëparshme, por jo më shumë se vlera aktuale, menjëherë para ndodhjes së ngjarjes së sigurimit;

**c. Malli, lëndet e para, produktet natyrore;**

- në rastin e objekteve të shkatërruara, të humbura ose të dëmtuara, Siguruesi do të dëmshpërblejë vlerën e tyre përkatëse, por jo më shumë se, shuma e siguruar sipas neneve 20 dhe 21/c, dhe përcaktuar në Policën e Sigurimit.

**d.** nga dëmshpërblimi do të zbritet vlera e pjesëve të mbetura ose të shpëtuara;

**e.** nuk do të merren parasysh shpenzimet për punimet restauruese të vendosura nga autoritetet shtetërore dhe shpenzimet shtesë që janë rrjedhojë e progresit teknologjik.

**54.** Dëmshpërblimi maksimal që do të paguajë Siguruesi për çdo dëm, nuk mund të kalojë shumën e siguruar, të rënë dakord për secilin objekt e të shënuar në policë.

**55.** Siguruesi mund të shtyjë kohën e pagesës:

- a. për aq kohë sa ekzistojnë dyshime të arsyeshme, mbi të drejtën e të Siguruarit për të fituar dëmshpërblimin;
- b. në qoftë se janë filluar hetime penale në lidhje me ngjarjen e sigurimit kundër të Siguruarit;
- c. për aq kohë sa i Siguruarit nuk paraqet dhe plotëson dokumentet e kërkuara nga Siguruesi.

**56.** Pas likuidimit të dëmshpërblimit, objektet mbeten të siguruar deri në mbarim të afatit të kontratës së sigurimit për diferencë midis shumës së siguruar dhe dëmshpërblimit të paguar, duke bërë për këtë shënime të veçanta në policën e sigurimit.

Me kërkesën e të Siguruarit, shuma e siguruar mund të rritet për të arritur shumën origjinale duke paguar prim shtesë dhe duke bërë shënime përkatëse në policën e sigurimit.

**57.** Siguruesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së dokumentave të nevojshme e të kërkuara lidhur me dëmin, nga i Siguruarit, detyrohet që:

- a. të bëjë pagesën e dëmshpërblimit, në rast të vërtetimit të ngjarjes së sigurimit,
- b. të shpjegojë arsyet e refuzimit, në rast të refuzimit të kërkesës të Siguruarit.

Për vonesat e shkaktuara si pasojë e veprimeve të Siguruesit tej afatit të përcaktuar si më sipër, do të paguhet interes vjetor në favor të Siguruarit, deri në masën 4 per qind në vit, mbi shumën e dëmshpërblimit.

**58.** Mosmarrëveshjet në qoftë se nuk zgjidhen me mirëkuptim, do të zgjidhen nga Gjykata e vendit ku është lidhur Polica e Sigurimit.

**Shtojca LMA5393, dt. 25.03.2020** “Për Semundjet e Shpalluara” aplikohet në të gjithë mbulimet, shtojcat, mbulimet shtesë, përjashtimet e çdo përjashtimi, dhe çdo mbulimi të dhënë tjetër në këtë policë.